



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 24.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.11.2023 të parashtruar nga Operatori ekonomik “PE -VLA-KU” SH.P.K.- DEGA NË KOSOVË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-11804-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-171-211, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: “PE -VLA-KU” SH.P.K.-DEGA NË KOSOVË, e dt.23.11.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-11804-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-171-211, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 10.11.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË e publikuara me datë: 10.11.2023;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “PE -VLA-KU “ SH.P.K.- DEGA NË KOSOVË me dt.23.11.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve te KPSH-së dhe QPS-së”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-11804-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-171-211.



Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 24.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues, ka vepruar konformë Nenit: 68 dhe Nenit ,69 ligjit te LPP-së.

Udhëzuesi Nr.01/2023 Për Prokurim Publik

Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se. AK-të mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave për gjendjen ekonomike dhe financiare nga lideri i grupit të OE.

Shembull:

Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000 euro dhe AK, mund të përcaktoj ne Njoftimin për kontrate se lideri i grupit preferohet të përmbush se paku 51% e këtij qarkullimi minimal.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

